

VENDIM
Nr. 73, datë 8.2.2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 60, DATË 6.2.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DËRGIM PERSONELI ME MISION
HUMANITAR NË TURQI, NË MBËSHTETJE TË AUTORITETEVE TURKE PËR
PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR NGA TËRMETI I DATËS 6 SHKURT
2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 60, datë 6.2.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “... 53 (pesëdhjetë e tre) ...” zëvendësohet me “... 73 (shtatëdhjetë e tre) ...”.

b) Në pikën 3, pas fjalës “... Gaziantep ...” shtohen fjalët “... dhe Adana ...”.

c) Në pikën 4, pas fjalëve “... deri në 3 (tre) muaj ...” shtohen “... me sistem rotacioni ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama